



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2022

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022, si në vijim:

1.1 Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2022:


- 1.1.1 Projektligji për Ekspertët Gjyqësorë (MD), afati i miratimit në Qeveri 15.10.2022;
- 1.1.2 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (MD), afati i miratimit në Qeveri 30.11.2022;
- 1.1.3 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2022, (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2022;
- 1.1.4 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 18.05.2022;
- 1.1.5 Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2022;
- 1.1.6 Projektligji për Tatimin në të Ardhurat Personale (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2022;
- 1.1.7 Projektligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.12.2022;
- 1.1.8 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Punësimit dhe Inovacionit Social (EaSI) të Fondit Social Evropian Plus (ESF+) në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.10.2022; dhe
- 1.1.9 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (MMPHI), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2022.

1.2 Ndryshohet afati i miratimit nga Qeveria i Projektligjeve si në vijim:

- 1.2.1 Projektligji për Partneritetin Publiko-Privat (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.07.2022;
 - 1.2.2 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë dhe Projektit ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, KOSTT (Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh. A.) dhe KfW, Frankfurt am Main ("KfW") për projektin "Zhvillimi i sektorit të energjisë VII – Përmirësimi i rrjetit të transmetimit" (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 20.10.2022;
 - 1.2.3 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrje në programin e BE-së "Customs" për periudhën 2021-2027 (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 25.08.2022;
 - 1.2.4 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin "Fiscalis" për periudhën 2021-2027(MFPT), afati i miratimit në Qeveri 25.08.2022;
 - 1.2.5 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për projektin e politikave zhvillimore (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 25.08.2022;
 - 1.2.6 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, për projektin e politikave zhvillimore (MFPT), afati i miratimit në Qeveri 15.09.2022;
 - 1.2.7 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L/-25 për Prokurorinë e Shtetit (MD), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2022;
 - 1.2.8 Projektligji për Avokaturën Shtetërore (MD), afati i miratimit në Qeveri 30.06.2022;
 - 1.2.9 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L/-52 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-273 dhe Ligjin Nr. 05/L-103 (MD), afati i miratimit 30.06.2022;
 - 1.2.10 Projektligji për Shërbimin e Jashtëm (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 30.09.2022;
 - 1.2.11 Projektligji për Protokollin e Shtetit (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 30.07.2022;
 - 1.2.12 Projektligji për Diasporën (MPJD), afati i miratimit në Qeveri 30.07.2022;
- 1.3 Projektligjit për Avokaturën Shtetërore i ndryshohet emërtimi në: *"Projektligji për përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore dhe arbitrazh"* (MD).
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që Vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
 3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08-P-043 të datës 21.03.2022, jep mendim lidhur me Nismën Legjislative për Projektligjin për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson Nismën Legjislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si Nismë e cila është në pajtim me nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-025 për Nismat Legjislative.
3. Nisma Legjislative për Projektligjin për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës sipas Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës në shumë prej 340,936 € (treqind e katër dhjete mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë euro) për periudhën 2022-2024 si dhe 8 punëtorë shtesë. Kostoja shtesë buxhetore e paraqitur nuk është përfshirë në Ligjin Nr.08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 dhe vlerësimet për vitet 2023-2024, dhe nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.
4. Ky Vendim së bashku me mendimin e dhënë nga Ministria e Mbrojtjes, Opinionin e Departamentit të Buxhetit në MFPT dhe Opinionin ligjor të përputshmërisë me Acquis të BE-së të Zyrës Ligjore - ZKM, i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-066 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L- 229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit Nr. 03/L- 229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 07/67 i datës 9 mars 2022 me të cilin i janë propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit Kosovar të Konkurrencës si në vijim:
 - 1.1. Në vend të z. Hekuran Nikçi, Kryetar, znj. Neime Binaku - Isufi;
 - 1.3. Në vend të z. Shpend Miftari, anëtar, znj. Violeta Jakaj - Spaqi.
2. Pjesa tjetër e Vendimit të Qeverisë Nr. 07/67 të datës 9 mars 2022 mbetet e pandryshuar.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Vendimin së bashku me biografitë e të propozuarve t'ia procedojë për shqyrtim dhe emërim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për Implementimin e Reformave në Fushën e Inspektimeve, në këtë përbërje:
 - 1.1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit - Kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues nga Sekretariati Koordinues i Qeverisë në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues nga Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues nga Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit - anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues nga Departamenti Ligjor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit - anëtar;
 - 1.9. Përfaqësues nga Departamenti Ligjor në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar;
 - 1.10. Përfaqësues nga Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - anëtar;
 - 1.11. Përfaqësues nga Inspektorati Shëndetësor; - anëtar
 - 1.12. Përfaqësues nga Inspektorati Farmaceutik në Ministrinë e Shëndetësisë - anëtar;
 - 1.13. Përfaqësues nga Inspektorati Sanitar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë - anëtar;
 - 1.14. Përfaqësues nga Inspektorati Qendror i Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - anëtar.
2. Grupi punues sipas nevojës mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera, shoqërisë civile, sektorit privat apo donatorëve ndërkombëtarë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e tij, në cilësi të ekspertëve apo si vëzhgues të procesit.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Grupit Punues për këtë reformë me interes nacional, janë si vijon:
 - 3.1 Koordinimi, drejtimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve të organeve të ndryshme qeveritare (duke përfshirë nivelin lokal) për zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me reformën e fushës së inspektimeve;
 - 3.2 Mbikëqyrja e procesit të zbatimit të Ligjit të ri Nr. 08/L-067 për Inspektimet, në themelimin dhe funksionalizimin e Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm;
 - 3.3 Monitorimi i procesit të ndryshim-plotësimit dhe harmonizimit të ligjeve përkatëse dhe akteve nënligjore me Ligjin Nr. 08/L-067 për Inspektimet;
 - 3.4 Përgatitja e materialeve të nevojshme udhëzuese lidhur me fushën e inspektimeve, sipas nevojës;
 - 3.5 Zhvillimi i aktiviteteve të tjera të nevojshme për implementimin e suksesshëm të reformës së inspektimeve në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-067 për Inspektimet.
4. Të gjitha organet dhe zyrtarët qeveritarë obligohen që të bashkëpunojnë me grupin punues gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të grupit punues, të përcaktuara në këtë Vendim.
5. Mbledhjet e grupit punues mbahen vetëm nën kryesimin e zyrtarëve të emëruar në pikat 1.1 ose 1.2 të këtij Vendimi.
6. Pjesëmarrja dhe kryerja e detyrave të anëtarëve të këtij grupi punues, konsiderohet si pjesë e detyrave të rregullta të punës të të gjithë anëtarëve.
7. Të gjithë anëtarët obligohen që të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e thirrura. Në raste të jashtëzakonshme, kur pjesëmarrja nuk është e mundur, anëtari përkatës obligohet që të njoftojë Kryesuesin për mungesën dhe të kërkojë aprovim për zëvendësimin e tij/saj nga një përfaqësues tjetër nga institucioni i njëjtë.
8. Në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në këtë Vendim, grupi punues mbështetet në aspekt administrativ dhe profesional nga Zyra e Kryeministrit. Mbështetje në aspekt profesional do të ofrojë edhe Projekti i Bankës Botërore për Konkurrues-mërinë dhe Projekti i IFC për Përmirësimin e Klimës së Investimeve, financuar nga Qeveria Zvicerane.
9. Mënyra e punës, organizimi dhe modalitetet tjera të mbështetjes administrative dhe profesionale të grupit punues, varësisht prej nevojës vendosen nga anëtarët në takimet e grupit punues.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 53 paragrafi 1. dhe nenit 55 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi Nr.02/117 i datës 22.01.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin z. Kujtim Gashit i vazhdohet mandati i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit edhe për 3 (tre) vite, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ligji Nr. 03/L- 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që ka rregulluar statusin e nëpunësve civil si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale deri para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, në nenin 15, paragrafin 3 përcakton:

“Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe në fund të saj i propozon ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre (3) kandidaturat më të mira. Ministria përgjegjëse për administratë publike ia dërgon titullarit të institucionit për miratim (3) kandidaturat më të mira. Për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar”.

Ndërsa në paragrafin 4. të nenit 15, ky ligj përcakton se:

“Procedurat e hollësishme për emërimin në pozita të larta drejtuese përcaktohen me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Qeveria”.

Në kuptim të kësaj, rregullore e veçantë që ka rregulluar procedurat e hollësishme për emërimin në këto pozita ka qenë Rregullorja Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e cila në nenin 14, paragrafi 3 kishte të përcaktuar që:

“Për institucionet e ekzekutivit, Ministri përgjegjës për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar.”

Në vitin 2018, kjo rregullore është shfuqizuar nga rregullorja Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila në nenin 15, paragrafin 7 gjithashtu përcakton se:

“Ky kandidat do të emërohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar”.

Pra, të dyja rregulloret e veçanta që kanë rregulluar procedurat e hollësishme për emërimin në pozita të larta drejtuese për periudhat kohore sa kanë qenë në fuqi, si autorizim ligjor për nxjerrjen e tyre kanë nenin 15, paragrafin 4 të Ligji Nr. 03/L- 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe si të tilla, që të dyja rregulloret sa i përket mandatit të nëpunësit të pozitës së lartë drejtuese kanë përcaktuar që emërohet **për një mandat 3 vjeçar**, kjo në përputhje të plotë me nenin 15, paragrafin 3. të Ligjit për Shërbimin Civil.

Vendimi i Qeverisë Nr.02/117 i datës 22.01.2020, përmes të cilit z. Kujtim Gashit i vazhdohet mandati i tretë me radhë sipas Ligjit për Shërbimin Civil, në preambulën e tij mbështetet vetëm në emërtime të akteve ligjore dhe nënligjore, pra Ligjit për Shërbimin Civil dhe në Rregulloren Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke mos përcaktuar nenet specifike që autorizojnë vazhdimin për një mandat të tretë për pozitat e larta drejtuese.

Rregullorja 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si autorizim ligjor për nxjerrje të saj ka nenin 16, paragrafin, nenin 75 paragrafin 5, nenin 76, paragrafin 2 si dhe nenin 88, paragrafin 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, të cilat rregullojnë zbatimin e programeve të veçanta për ndërtimin e kapaciteteve dhe lëvizjen e nëpunësve, procedurën disiplinore, procedurën për vlerësimin e performancës si dhe procedurën e shkarkimit të zyrtarëve në pozitë të lartë drejtuese por jo mandatin apo vazhdimin e tij. Sidoqoftë, kjo Rregullore në nenin 22 parasheh vazhdimin e mandatit të zyrtarit të lartë drejtues, duke potencuar që:

“Nëse pas tri (3) vitesh Ministri e konsideron të kënaqshme performancën e zyrtarit të lartë drejtues, atëherë ai/ajo i drejtohet Këshillit së bashku me një arsyetim për vazhdimin e kontratës së zyrtarit të lartë për një mandat tjetër 3 vjeçar”.

Dispozita e lartcekur është në kundërshtim me Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil, marrë parasysh që ky i fundit parasheh vetëm **një mandat 3 vjeçar** për pozita të larta drejtuese. Vazhdimi i mandatit të këtillë në bazë të performancës së kënaqshme, ashtu siç e specifikon Rregullorja e lartcekur, shkel dispozitat ligjore. Së fundmi, edhe në rast të aplikueshmërisë së Rregullores 06/2012 dhe validitetit të nenit 22 në këtë rast, përsëri nuk do mund të arsyetohej mandati i tretë, të cilin aktualisht gëzon z.Kujtim Gashi. Vazhdimi i njëpasnjëshëm i ushtrimit të detyrës, humb në tërësi arsyeshmërinë e mandatit, të paraparë me Ligjin 03/L-149 për Shërbimin Civil, si një të vetmit, në raport me pozita të larta drejtuese.

As ligji Nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare për Shoqërinë e Informacionit nuk përcakton rregullim të mandatit apo vazhdim të tij sepse në nenin 7, paragrafi 1. ka përcaktuar se:

“Agjencia udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet në pajtim me rregullat dhe procedurat për emërimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës”.

E rregullat dhe procedurat për emërimin e pozitave të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht Ligji Nr. 03/L- 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe rregullorja e veçantë e autorizuar në kuptim të nenit 15, paragrafit 4 të këtij ligji, nuk kanë paraparë vazhdim të mandatit të dytë, rrjedhimisht as për një mandat të tretë.

Ligji, po ashtu edhe rregullorja Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kanë përcaktuar qartë se emërimi në pozitë të lartë drejtuese **bëhet për një mandat 3 vjeçar**.


Në dritë të asaj që u tha më lart, konfirmohet se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 02/117 i datës 22.01.2020 për vazhdim të mandatit edhe për 3 (tri) vjet Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit – z. Kujtim Gashi, është në kundërshtim të plotë me dispozitat e ligjit material gjegjësisht është në kundërshtim me dispozitat e nenit 15, paragrafin 4. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe me nenin 15, paragrafin 7 të rregullores Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative në nenin 52 paragrafin 1. nën paragrafin 1.5 është përcaktuar qartë se *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:[...] është në kundërshtim me ligjin material”*.

Andaj, nga sa u tha më lart, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë në këtë procedurë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 paragrafit 1. dhe nenit 55 paragrafit 1. të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afatit 30 ditësh, pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Z. Kujtim Gashi
- DMZP
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/69
Datë: 13.04.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 39, 44, dhe nenit 45 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim dhe krijimi i detyrueshëm i servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga implementimi i projektit: Ndërtimi i Linjës 2x 110kV "Kastrioti" në Qytetin e Ferizajt, zonat kadastrale: Prelez i Jerlive, Kosinë, Muhoc, Lloshkobare, Ferizaj dhe Talinoc i Jerlive, Komuna e Ferizajt, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Kompensimi i pronës së shpronësuar dhe të gjitha obligimet tjera financiare dhe ligjore që mund të rrjedhin nga procesi i shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhet nga buxheti i Subjektit Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A).

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 9 nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 08/L-021 për Tregti me Jashtë dhe nenit 42 nën-paragrafi 1.b. dhe nenit 43 paragrafi b. të Ligjit Nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për ndalimin e përkohshëm të eksportit dhe riekportit të produkteve themelore agro-ushqimore

1. **Ndalohet** përkohësisht eksporti dhe riekporti i produkteve themelore agro-ushqimore në vijim, të identifikuara me kodet dhe përshkrimet nga Tarifa e Integruar e Kosovës (TARIK) e vitit 2022:

1001	grurë dhe meslin:
	– grurë i fortë (durum):
1001 1100 00	– – farë
1001 1900 00	– – të tjera
	– të tjera:
1001 91	– – farë:
1001 9110 00	– – – spelt
1001 9120 00	– – – grurë i zakonshëm dhe meslini
1001 9190 00	– – – të tjera
1001 9900 00	– – të tjera
1005	misër (dridhë):
1005 10	– farë:
	– – hibrid:
1005 1013 00	– – – hibrid tre-kryqëzime
1005 1015 00	– – – hibride të thjeshta
1005 1018 00	– – – të tjera

1005 1090 00	-- -- të tjera
1005 9000 00	-- të tjera
1101	miell gruri dhe miell meslini:
	-- miell gruri:
1101 0011 00	-- prej grurit të fortë
1101 0015 00	-- prej grurit të zakonshëm dhe spelt
1101 0090 00	-- miell meslini
1102	miellra të drithërave të ndryshme prej grurit dhe meslinit:
1102 20	-- miell misri (si drithë):
1102 2010 00	-- me një përmbajtje yndyrë jo më tepër se 1,5 % ndaj peshës
1102 2090 00	-- të tjera
1102 90	-- të tjera:
1102 9010 00	-- miell elbi
1102 9030 00	-- miell tërshëre
1102 9050 00	-- miell orizi
1102 9070 00	-- miell thekre
1102 9090 00	-- të tjera
1103	bollgur drithërash, kokrriza dhe sfera të drithërave:
	-- bollgur dhe kokrriza:
1103 11	-- prej grurit:
1103 1110 00	-- -- prej grurit të fortë
1103 1190 00	-- -- prej grurit të zakonshëm dhe për mbjellje
1103 13	-- prej misri (si drithë):
1103 1310 00	-- -- të një përmbajtjeje yndyre jo më tepër se 1,5 % ndaj peshës
1103 1390 00	-- -- të tjera
1103 19	-- prej drithërave të tjera:
1103 1920 00	-- -- prej thekrës apo elbi
1103 1940 00	-- -- prej tërshërës
1103 1950 00	-- -- prej orizit
1103 1990 00	-- -- të tjera


1512	vaj luledielli, vaj <i>safflower</i> (një bimë e ngjashme me gjembaç (<i>Carthamus tinctorius</i>) që kultivohet në Indi) dhe vaj i farave të pambukut dhe fraksionet e tyre, nëse janë apo jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht: – vaj i farave të lulediellit apo vaj <i>safflower</i> dhe fraksionet e tyre:
1512 11	– – vaj i papërpunuar:
1512 1110 00	– – – për përdorim teknik apo industrial ndryshe nga prodhimi i ushqimeve për konsum njerëzor – – – të tjera:
1512 1191 00	– – – – vaj luledielli
1512 1199 00	– – – – vaj <i>safflower</i>
1512 1990 00	– – – të tjera
1701	sheqer i prodhuar nga kallamsheqeri apo nga panxharsheqeri dhe saharoza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë: – të tjera:
1701 99	– – të tjera:
1701 9901 00	sheqer i bardhë
2501 00	kripë (duke përfshirë kripën e tavolinës dhe kripën e denaturuar) dhe klorur natriumi i pastër, qoftë apo jo në solucion ujor nëse përmban apo jo agjente shtesë kundër aglomerimit apo agjente që sigurojnë një fluiditet të mirë; uji i detit: – – – të tjera:
2501 0091 00	– – – – kripë e përshtatshme për konsum njerëzor

2. **Detyrohen** institucionet përgjegjëse të zbatojnë këtë Vendim.
3. **Detyrohet** Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të vëzhgojë tregun ndërkombëtar, të mbikëqyrë tregun e brendshëm, të marrë masa sipas ligjit kundër praktikave të ndaluara tregtare, si dhe të propozojë rishikimin e këtij Vendimi sipas nevojës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke vërejtur vështirësitë në furnizim me produkte themelore të bujqësisë dhe ushqimit në tregjet botërore dhe në Republikën e Kosovës dhe me qëllim për të zbutur efektet e situatës, u vendos si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Doganës së Kosovës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/69
Datë: 13.04.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen masat për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, me masat si në vijim:
 - 1.1. Të gjithë përfituesit e skemës së asistencës sociale që kualifikohen për përfitim, marrin vlerën e dyfishuar të asistencës për muajin Prill të vitit 2022;
 - 1.2. Të gjithë përfituesit e skemave pensionale dhe sociale që kualifikohen për përfitim, mbështeten me shumën e njëhershme prej 100 € (njëqind euro) për muajin Prill të vitit 2022;
 - 1.3. Të gjithë punëtorët e sektorit privat, që kualifikohen për përfitim dhe që marrin pagë primare deri 1000 €, (në njëmijë euro), mbështeten me shumën e njëhershme në vlerë prej 100 € (njëqind euro);
 - 1.4. Të gjithë punonjësit e sektorit publik, që kualifikohen për përfitim dhe që marrin pagë primare deri në 1000 € (njëmijë euro) nga buxheti i shtetit, mbështeten me shumën e njëhershme në vlerë prej 100 € (njëqind euro); dhe
 - 1.5. Të gjithë studentët aktivë dhe të rregullt, që kualifikohen për përfitim dhe që janë të regjistruar në universitetet publike dhe private në Republikën e Kosovës, mbështeten me shumën e njëhershme në vlerë prej 100 € (njëqind euro).
2. Asnjë përfitues nuk mund të përfitojë më shumë se një herë nga masat sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Autorizohet Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve që nëpërmjet vendimeve të përcaktojë kriteret shtesë, procedura dhe veprime përkatëse për realizimin e masave të përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të sigurojë buxhetin e nevojshëm për realizimin e masave, në përputhje me Ligjin Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 si dhe legjislacionin tjetër përkatës për menaxhimin e financave publike.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe të gjitha institucionet tjera përkatëse të përcaktuara sipas pikës 3. të këtij Vendimi, për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021, të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimin e Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dyfishimi i pagesës për përfituesit e skemës së ndihmës sociale për muajin Prill 2022, në kuadër të zbatimit të masës 3.2- Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Për zbatimin e pikës 1. të këtij Vendimi, Thesari i Kosovës autorizohet paraprakisht, të bëjë alokimin e parakohshëm të mjeteve buxhetore nga programet përkatëse buxhetore, për përmbushjen e plotë të këtij Vendimi.
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/69
Datë: 13.04.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021, të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Vendimin e Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike Nr.13/19 të datës 14.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet pagesa shtesë në vlerë të mbështetjes financiare prej 100 € (njëqind euro) për përfituesit e skemave pensionale, përfituesit e skemës për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme dhe përfituesit e skemës së strehimit familjar për muajin Prill 2022, në kuadër të zbatimit të Masës 3.2 - Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Të gjithë përfituesit e skemave pensionale dhe sociale përfitojnë shtesën sipas pikës 1. të këtij Vendimi, të kufizuar në bazë të kriterëve si në vijim:
 - 2.1. Vlera e pensioneve aktuale që përfiton një individ të mos e kalojë shumën 500 € (pesëqind euro) në muajin Prill 2022; dhe
 - 2.2. Shtesa paguhet vetëm njëherë për një person.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi, Thesari i Kosovës autorizohet paraprakisht të bëjë alokimin e parakohshëm të mjeteve buxhetore nga programet përkatëse buxhetore të skemave pensionale, për përmbushjen e plotë të këtij Vendimi.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e plotë të këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 13,610,000 € (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e dhjetë mijë euro), për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr.01/49 të datës 17.12.2021 dhe Vendimin Nr.15/62 të datës 23.02.2022 (këtej e tutje referuar si "Vendimi i Pakos së Ringjalljes Ekonomike") lidhur me Masat 2.1, 3.4, 4.3 dhe 4.4 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Programi i Ringjalljes Ekonomike, nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" dhe ndahen, si vijon:
 - 2.1. Në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (204) ndahet shuma prej 5,000,000 € (pesë milionë euro), në nën-programin Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, me kod 49000, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" për zbatimin e Masës 2.1 - Subvencionimi i kredive investive;
 - 2.2. Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (201) ndahet shuma prej 2,300,000 € (dy milionë treqind mijë euro) në nën-programin Ndihmat sociale, me kod 00500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 3.4 - Kuponë ushqimi për familjet në nevojë;
 - 2.3. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (207) ndahet shuma prej 260,000 € (dyqind e gjashtëdhjetë mijë euro) në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", për zbatimin e Masës 4.3- Mbështetja e Kulturës dhe Sportit, në programet me detajet si vijon:
 - 2.3.1. Në nën-programin Sportet e Gjëra, me kod 80100, shuma prej 140,000 € (njëqind e dyzet mijë euro), dhe
 - 2.3.2. Në nën-programin Përkrahja e Kulturës, me kod 80500, shuma prej 120,000 € (njëqind e njëzet mijë euro).
 - 2.4. Në Ministrinë Punëve të Brendshme (214) ndahet shuma prej 6,050,000 € (gjashtë milionë e pesëdhjetë mijë euro) në nën-programin Shërbimet e Mbështetjes, me kod 30400, në kategorinë e shpenzimeve "Shpenzime Kapitale", në projektin me kod 12205, për zbatimin e Masës 4.4 - Mbështetja e Sigurisë.

3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programet përkatëse, pas përfundimit të procesit dhe aprovimit të listës së përfituesve, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara për masat përkatëse.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Ministria Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin për "Zhvillimin e Ujërave të Zeza në Gjilan".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për "Financimin e Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe Krijtje të Qëndrueshme".
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes për bashkëpunimin Ekonomik ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Organizimin e Tregut të Përbashkët të Produkteve Bujqësore.
2. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/69
Datë: 13.04.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8, 14 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2022, merr këtë

V E N D I M

1. Themelohet Komiteti Drejtues për zbatimin e projekteve të rehabilitimit të linjave hekurudhore, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, kryesues;
 - 1.2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.3. Ministria e Ekonomisë, anëtar;
 - 1.4. Infrakos, anëtar;
 - 1.5. Njësia për Zbatimin e Projektit - Infrakos, anëtar;
 - 1.6. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Evropiane për Investime do të ftohen dhe të marrin pjesë në takimet e KD si vëzhgues.
2. Në takimet e Komitetit Drejtues, sipas nevojës mund të ftohen edhe përfaqësues të palëve të interesit dhe ekspertë të ndryshëm.
3. Komiteti Drejtues do të jetë përgjegjës për menaxhim dhe mbikëqyrje të nivelit të lartë të Projektit dhe të sigurojë se është bërë progres drejt arritjes së synimeve dhe objektivave të Projektit sipas termeve, kushteve dhe procedurave të Kontratës së Financiare të nënshkruar në mes të BEL, BERZh dhe Kosovës.
4. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë